



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS
01Nr. 104/02-24329 /23
Kaçanik, 15.09.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Ligjit Nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunëses civile, znj. Arbnora Kuka, Zyrtare e lartë për shëndetësi në kuadër të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale i caktohen detyra shtesë jashtë funksionit të caktuar të saj, përkatësisht ngarkohet edhe me detyrat e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave personale .
2. Punët dhe detyrat si Zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale do ti kryejë përkohësisht, deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Bazuar në Ligjin Nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), si mbikëqyrës i zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim të mbështetjes për përmbushjen e obligimeve ligjore ka kërkuar që të caktohet me vendim Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale.

Prandaj, duke u mbështetur në kërkesën e cekur më lartë dhe për të përmbushur obligimet ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale është konstatuar që të caktohet përkohësisht një zyrtar që do të kryejë këtë pozitë.

Andaj, duke pasur parasysh këto që i theksuam më lartë, përgatitjen profesionale të zyrtares, u konstatua se zyrtarja në fjalë krahas kryerjes së detyrave në vendin e saj të punës, mund t'i kryej edhe detyrat në pozitën Zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen;

-znj. Arbnora Kuka

-Zyra e personelit

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi